



Prishtinë, 20 dhjetor 2011  
Kodi i ZRRE-së: V\_387\_2011

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 17 dhe 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Kërkesën për pezullimin e procedimit të aplikacionit për shndërrimin e njoftimit mbi vendimin preliminar në Autorizim, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 26 MW, në lokacionin fshati Poliçkë, KK Dardanë, të datë 27.10.2011 të ndërmarrjes AIR-ENERGY sh.p.k, me adresë rruga “Isa Boletini” 6000,Gjilan, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2011 nxori këtë:

## VENDIM

- I. **PËRFUNDON** afati i vlefshmërisë së vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_204\_2009 i datës 22 shtator 2009, **dhe NDËRPREHET** procedura e shqyrtimit të aplikacionit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 26 MW, në lokacionin fshati Poliçkë, KK Dardanë, të ndërmarrjes AIR-ENERGY sh.p.k, me adresë rruga “Isa Boletini” 6000,Gjilan, Republika e Kosovës.

## Arsyetim

- ZRRE me datë 09.03.2009 nga ndërmarrja AIR-ENERGY sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 26 MW, në lokacionin fshati Poliçkë , KK Dardan.
- Me datë 22 shtator 2009 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga ndërmarrja AIR-ENERGY sh.p.k., ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteti të ri gjenerues nga burimet e ripërtrishme të energjisë (BRE) nga era dhe ju ka lëshuar Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_204\_2009.
- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Me datë 20.09.2011 ZRRE nga ndërmarrja AIR-ENERGY sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e njoftimit mbi vendimin e autorizimit preliminar në Autorizim.



- ZRRE me datë 27.10.2011 nga ndërmarrja AIR-ENERGY sh.p.k., ka pranuar kërkesën për pezullimin e procedimit të aplikacionit për shndërrimin e njoftimit mbi vendimin preliminar në Autorizim, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 26 MW, në lokacionin fshati Poliqkë, KK Dardanë.
  - ZRRE pas analizimit të kërkesës për pezullimin e procedimit të aplikacionit, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- III.** Me këtë vendim shfuqizohet vendimi V\_204\_2009 i datës 22 shtator 2009, i lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Enver Halimi, anëtar